



20 DITË
RRETHUAR

Tema

E MËRKURË 28 JANAR 2009
WWW.TEMA.AL

Tema

30
LEKË

Gazetë e përditshme
Numër 2575 | Viti IX



Nga e hëna në të enjte, në "Vizion Plus", ora 23:00

OPINION 6 LUFTA PËR KQZ DHE
EMRAT E MUNDSHËM
NGA LEK ZADRIMA

OPINION 11 KUR KUVENDI DREJTOHET
SI KAFENE LAGJESH
NGA ARMAND MAHO

OPINION 11 SHQIPËRIA DHE KOSOVA DUHET T'I
ZBARDHIN KRIMET E KOMUNIZMIT
NGA BLERIM ÇOÇAJ

OPINION 10 LUFTA
PËR LIBREZA
NGA BATON HAXHIU

EDITORIAL

Topalli, si drejtuese e Plenumit të radhës

Mero Baze
mero.baze@tema.al

NJË PËRFAQËSUES i shumicës së Shqipërisë në Strasburg kishte arritur falë lobimit të tij dhe rrethanave të papërsëritshme të ishte nënkryetar i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Për arsye tërësisht të brendshme në PD dhe sidomos për shkak të nevojës për t'u kualifikuar si qendër pushteti, zonja Topalli ia ndërpret këtë mandat duke e përjashtuar fare dhe nga delegacioni i KiE. Kjo bën që automatikisht Shqipëria të humbasë një përfaqësim ndërkombëtar që s'e ka pasur më parë dhe të lakohet si një vend me probleme në funksionimin e demokracisë së brendshme. Por rëndësia më e madhe e këtij vendimi arbitrar qëndron te mosfunksionimi i institucioneve të PD.

Përjashtimi i Biberajt si nevojë e brendshme për të konfirmuar lidere të Plenumit të radhës kundër grupeve armiqësore zonjën Topalli, duhej të merrte doemos miratimin formal të strukturave udhëheqëse të PD, para se të kryhej veprimi. Duke u vënë para faktit të kryer, ato natyrisht e miratuan këtë gjest, por bashkë me të kanë miratuar nisjen e një debati të ashpër brenda PD mbi mënyrën... ■ 10

Komentoni në webfaqen tonë www.tema.al

DOSJA

Fazlliq dhe Lazareviç, biznes karburantesh në Shqipëri

Studioja e Argitës, përfaqësuese e pronarit të firmës serbe, RUDNAP, në Tiranë

LIDHJA MES DAMIR FAZLLIÇIT dhe pronarit të firmës serbe, RUDNAP, (Vojin Lazareviç), është kristalizuar qartazi në mes të Tiranës, në dy firma të përbashkëta karburantesh. Kjo edhe falë kontributit të studios legale të Flutura Kolës, e cila është e njohur për ortakërinë... ■ 3-5

INTERVISTA ALEKSANDËR BIBERAJ: MOTIVET E SHKARKIMIT TIM NGA TOPALLI



ANTENA BRENDA FAMILJES

PAGE 2

Flamuri nxehet me Jozefinën për numrin 2, pas atij burrit

INTERVISTA ■ Greenway: Tejet e pazakonshme kjo që po ndodh me rastin Biberaj ■ 7

POLITIKA ■ Kryeministri shkarkon drejtorin e Tatimeve ■ 7

QËNDRIMI ■ PS: Problemet me kartat janë ogur i keq për zgjedhjet ■ 12

KULTURA ■ Shpirti i zbardhur që lëshon tinguj - Nga Ali D. Jasiqi ■ 14-15

VENDIMI 8

Gjyqtarët e Apelit: Gjykimi i Bashës, kompetencë e Gjykatës së Lartë

OPOZITA 13

Për privatizimin e INSIG ka informacion vetëm familja Berisha

Gazeta "Tema" s'ka më adresë. Çdo informacion mund të dërgohet me e-mail ose në numrat mobile që janë në gazetë





Shpirti i zbardhur që lëshon tinguj

Mendime për përmbledhjen e Gjekë Marinajt "Lutje në ditën e tetë të javës". Botoi "Faik Konica" Pristinë - 2008

Ali D. Jasiqi

NGANJËHERË POEZIA nuk ka nevojë për komente të gjata hyrëse. Ajo është art që me esencën që gjendet në fjalët dhe vargjet e saj është efi-kase për lexuesin se sa esenca që gjendet në fjalët e kritikës që e analizon atë. E tillë është edhe poezia e Gjekë Marinajt e përfshirë në këtë vëllim poetik. Prandaj le t'i referohemi direkt poezisë së tij.

Poezitet e dy cikleve ("Lutjet e së dielës" dhe "Ailuropoda në gjyqin e fjalës") të përmbledhjes së poezive, që kanë një titull përplot simbolikë, "Lutje në ditën e tetë të javës" të Gjekë Marinajt subjekt lirik kanë krijimtarinë letrare, më konkretisht poezinë, si shprehje e ndjenjave të thella dhe të sinqerta të qenies njerëzore. Poezitet për poezinë janë shkruar në atë mënyrë që mund të themi në dy forma. Derisa një pjesë e tyre paraqesin mendimet e autorit për problemet e përgjithshme për poezinë e letërsinë në përgjithësi, të tjerat u janë kushtuar poetëve të njohur shqiptarë e botërorë, siç janë: Gjergj Fishta, Migjeni, Frederik Reshpja, Dalan Luzaj, Luigi Çekaj, por edhe Pablo Neruda, Homeri e ndonjë tjetër. Jo vetëm në këta dy cikle, por edhe në disa poezi të cikleve të tjera autori i kthehet këtij subjekti lirik.

Çka është poezia, përkatësisht krijimtaria letrare, sipas mendimit të shprehur në krijimet e tij poetike të Gjekë Marinajt?

Përgjigjen e gjejmë në vargjet e poezive të tij, qofshin ato të përgjithshme apo edhe ato kushtuar personaliteteve të shquara letrare. Sipas këtij orientimi poezia është shpirt i zbardhur që lëshon tinguj përplot filozofi dhe ndjenja, që i mbledh krijuesi në vete. Gjekë Marinaj kërkon që kani-balët t'i shpërthejnë kthetrat dhe të bëhen kafshë, e kafshët të bëhen humane, humanët të shndërrohen në engjëj e engjëjt të zbrasin nga parajsja në tokë dhe të bëhen poetë, e poetët të shkrihen në vargje dhe kështu të krijohet poezia, e cila do të pësojë një tjetër metaforë dhe të bëhet "provë e së vërtetës objektive" të "Platonit", me një fjalë çdo gjë në botë të ndryshojë në të mirë të njerëzimit. Andaj është fare e natyrshme që "sa herë jep shpirt një poet diçka vdes brenda meje" – do



Gjekë Marinaj

të shprehet poeti, i bindur se nderi e të themi edhe burrëria, për poetët është si frymëmarrja, pa të cilën njeriu vdes dhe se ai, poeti pra:

*"Mbi fletën e bardhë
Sytë i kthehen në syze.*

*Me krenarinë e një lapsi
Të mprehur hollë
Vetëm ecën*

Derisa mbarohet duke shkruar diçka"

("Poeti")

Kjo është një poezi e shkurtër, por përmbajtjesore, që ngërthen në vete mendimet e poetit për krijimtarinë letrare, për angazhimin e tij krijues, i cili me krenarinë e një lapsi ecën

i vetmuar derisa të krijojë vepra letrare, ecën derisa të harxhohet mjeti me të cilin shkruhet poezia, lapsi. Mendimet e veta për krijimtarinë, përkatësisht për angazhimin e krijuesve në punën e tyre autori i përmbledhjes "Lutje në ditën e tetë të javës" e ka shprehur në këtë mënyrë: "Për mendimin tim, artistët janë heronjtë me të ndershëm që ka kombi ynë. Të jesh sot artist do te thotë të shqyesh nga shpirti për të krijuar dhe të rrjepësh nga lëkura e kurrijit për të botuar. Por, ngaqë nuk mund të leme pas dore këtë punë, nuk na e ka kush fajin." Kështu i ka shkruar Gjekë Marinaj Kolec Traboinit, për të vazhduar mandej në shkrimin për vëllimin poetik "Mos vdis dashuri" me konstatimin se "nuk është gjë

tjetër veçse një kopje e regjistrimeve jetësore në hapësirën e bardhë të shpirtit të Kolec Traboinit. Në dy anët e peshores së drejtësisë së tij poetike, gjenden të ekuilibruara dashuria për botën dhe shqetësimi qytetar për kohën që jetojmë. Koncepti filozofik i autorit shtrihet përtej dhimbjes që krijoi gjuha e poetikës moderne. Për të universi nuk është perfekt dhe kjo joperfektësia rritet në një laborator tepër të komplikuar njerëzor. Ndaj "Mos vdis dashuri" na jepet me tepër si evidencë e pagjumësisë bashkëkohore, sesa si një medikament për të kuruar atë". Këto vlerësime për poezinë e Traboinit, në njëfarë mënyrë shfaqin edhe mendimin dhe konceptet që i ka Gjekë Marinaj për poezinë, përkatësisht për krijimtarinë letrare

“

Poezia e tij, në pjesën më të madhe është reflektive, përkatësisht meditative, për të mos thënë edhe me nuanca të poezisë filozofike. Gjekë Marinaj do të meditojë për shumë probleme jetësore, për qëndrimin e njeriut ndaj dukurive të ndryshme në natyrë dhe përgjithësisht në jetë

në përgjithësi. Andaj është fare e natyrshme që kjo frymë i përshkon të gjitha poezitë, qofshin ato kushtuar krijuesve letrarë, emrat e të cilëve i zumë në gojë pak më lartë dhe të cilët janë:

"Metaforë që u jep dimensionin e tretë miteve

Mortar i antonimit të ndajfoljeve fjetur dhe zgjuar

Mburojë prej intelektit përballë krijësive bajate"

- vargje këto të poezisë "Fytyrat në rrethin e dytë të purgatorit" kushtuar Fishtës). Ndërsa në poezinë kushtuar Migjenit lexojmë edhe këto vargje:

"Ngaqë nëpër horizontet e syve që të



panë vetëm tmerr

Lumenjtë e skëterrës nuk rrodhën gjak të tërbuar

Shpirti skeptik i poezisë tënde nuk të përmbysi në vrerë.

(“ Migjenit ”)

Kjo frymë vërehet edhe te poezitë meditative, te ato në të cilat gjejmë mendimet e Gjekë Marinajt për problemet e artit e veçmas të letërsisë.

Poezia hyrëse “Autoportret i avancuar” dhe në të cilën me vargun e parë “Marlowe më ka bërë shumë nder me Faustin” duket se paralajmërohet orientimi krijues i Gjekë Marinajt. Kjo do të vërehet në të gjitha poezitë, që sipas tematikës që trajtojnë, janë radhitur edhe në këto cikle “Mesnatë pa datë në kalendar”, “24 orë dashuri”, “Duart e nënës”, “Rrëfimi i Rozafës”, “Sugjerim me zë të ulët” dhe “Labirintet e mendimeve të Tangunit”.

Krijues që vijimisht është në rrjedhat e letërsisë bashkëkohore amerikane, duke i përkthyer në shqipe disa poetë të kësaj letërsie, (Gjekë Marinaj ka përkthyer në shqip përmbledhjet “Ora e paqes” - përmbledhje nga Rainrs Scult, 2005 dhe “Në shpellën e Platonit” - poezi nga Frederik Turner 2006), do të mësojë mjaft nga kjo letërsi, do të mësojë për angazhimin, preokupimet, por edhe format e të shprehurit figurativ të këtyre krijuesve, për t'i përsosur ato në shkrimet e veta poetike.

Poezia e tij, në pjesën më të madhe është reflektive, përkatësisht meditative, për të mos thënë edhe me nuanca të poezisë filozofike. Gjekë Marinaj do të meditojë për shumë probleme jetësore, për qëndrimin e njeriut ndaj dukurive të ndryshme në natyrë dhe përgjithësisht në jetë. Do të meditojë edhe për qëndrimin e vet ndaj dukurive e fenomeneve të ndryshme, do të meditojë për qëndrimin që duhet mbajtur në situata të caktuara. Së këndeje ai do të shprehet:

“ Të më falë Milton, por për mua do të ishte më mirë

Të jem shërbëtor në parajsë se sa sundues në ferr


(“Autoportret i avancuar”)

Derisa poezia është shprehje e ndjenjave dhe mendimeve proza është lavë e skuqur që ngritët e lartësohet, gjersa të arrijë zenitin, krijimtari që kërkon mund e sakrificë që të jetë e suksesshme dhe kuptimplote, si krijimtari ku shuhen edhe fërkimet në sytë e një të vdekuri.

Gama e frymëzimit dhe e preokupimit të autorit të kësaj përmbledhje është mjaft e gjerë dhe e shumëllojshme. Ai do të këndojë edhe për dashurinë, e cila e ka prushin brenda, por nuk është zjarr

“

Gjekë Marinaj është treguar mjeshtër në përdorimin e mjeteve artistike të të shprehurit artistik, të gjetjes së figurave artistike në mesin e të cilave do ta veçonim metaforën, krahasimin, alegorinë e shumë të tjera. Dhe këto e bëjnë poezinë e tij të lexueshme dhe interesante jo vetëm për kritikën letrare, por edhe për lexuesin e rëndomtë



Libri i Gjekë Marinaj - «Lutje në ditën e tetë të javës»

dhe se dashuria e pashprehur është lojë e humbur. Për këtë autor thotë se në mos vdesësh për poezinë do të vdesësh prej saj, sepse ajo u fishkëllen njerëzve në vesh. Me një ngrohtësi të veçantë Marinaj do të thurë vargje për gruan, për Dositën, së cilës i ka kushtuar dy poezi të ngrohta. Ajo është:

Trëndafili im i vetëm përherë në çelje
Epiqendra e dashurisë time gjithnjë në rritje
(Dositës, në 14 vjetorin e martesës)

Ai do të shkruajë edhe poezi ku i këndohet atdheut, më konkretisht Kosovës, Shkodrës, por edhe Shqipërisë. Si dhe shumë poetë të tjerë edhe Gjekë Marinaj ka shkruar poezi për Nënë Terezën, përkatësisht për Gonxhe Bojaxhiun, ku gjejmë edhe këto vargje:

“Dha gjithçka
Kur s’kishte asgjë për të dhënë”
(“ Gonxhe Bojaxhiu”)
ose

“Jeta e saj
Imbylli kllapat”

dhe mbeti

“ Si një ekuacion
I pazgjidhur deri në fund”
(“Nënë Tereza”)

E tillë ishte kjo humaniste e dalluar me origjinë shqiptare që u bë e njohur në mbarë botën me veprën e saj, dhe e cila asnjëherë nuk e harroi origjinin e saj shqiptare. Të gjitha këto e kanë nxitur Agron Tufën, që në parathënien e përmbledhjes se dytë të këtij autori të konstatojë se “Infiniti” (ky është titulli i përmbledhjes së dytë të Marinajt, botuar në vitin 2000 - shënimi ynë A. J.) ashtu si gjithë poezia shqipe e vjetër dhe e re, ruan në qendër të saj unin lirik, porse tek Marinaj, ky farë uni lirik është i dhënë në modusin e objekteve rrëshqitëse, pamundësisë, mallit elegjik për atë “unë” të zhdukshëm në strukturat e ngurta dhe te vrazhda të botës”.

Ky konstatim i poetit dhe studiuesit të njohur Agron Tufa na duket i qëlluar dhe me vend. Dhe ne do të shtonim se të gjitha këto e bëjnë poezinë e tij të veçantë në letrat shqipe, poezi e cila sjell freski, sjell elemente të reja. Gjekë Marinaj është treguar mjeshtër në përdorimin e mjeteve artistike të të shprehurit artistik, të gjetjes së figurave artistike në mesin e të cilave do ta veçonim metaforën, krahasimin, alegorinë e shumë të tjera. Dhe këto e bëjnë poezinë e tij të lexueshme dhe interesante jo vetëm për kritikën letrare, por edhe për lexuesin e rëndomtë. Në këtë vazhdë është edhe përmbledhja “Në ditën e tetë të javës”, që është një ndër realizimet e suksesshme në letërsinë shqipe.

I pari workshop për “Katalogimin e trashëgimisë kulturore shpirtërore”

KËSHILLI I MUZIKËS SHQIPTARE, në bashkëpunim me Komisionin Kombëtar të UNESCO-s, në kuadër të projektit “Safeguarding the Albanian Folk Iso-Polyphony- a Unesco masterpiece of the Oral and Intangible Heritage of Humanity”, 25 November, 2005, me mbështetjen e UNESCO/Japan Funds-in-Trust për Ruajtjen dhe Promovimin e Trashëgimisë Shpirtërore, do të organizojnë workshopin: “Katalogimi i trashëgimisë kulturore shpirtërore” më datë 28 Janar, ora 10.00, në sallën e Muzeut Historik Kombëtar. Në workshop do të marrin pjesë specialistë të fushës, punonjës të institucioneve kulturore të trashëgimisë kulturore në qendër dhe në bazë, studentë dhe të interesuar të fushës së trashëgimisë kulturore shpirtërore. Siç dihet, katalogimi i vlerave të trashëgimisë kulturore shpirtërore është një fushë e re pune për trashëgiminë kulturore shqiptare. Ligji 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgimisë kulturore”, i ndryshuar parashikon krijimin e Komitetit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore, i cili ndër të tjera duhet të shpallë edhe listën tonë të “Kryeveprave të trashëgimisë kulturore shpirtërore”, kjo krahas listës së monumenteve të kulturës materiale e cila tashmë ekziston prej vitit 1948. Detyrimet për thellim të mëtejshëm në fushën e katalogimit të vlerave të trashëgimisë kulturore shpirtërore rriten pas shpalljes së “Iso-Polifonisë Popullore Shqiptare” si “Kryeveprë të trashëgimisë gojore të njerëzimit”-Unesco e në mënyrë të veçantë pas ratifikimit që Shqipëria i bëri Konventës së Unesco-s “Për trashëgiminë shpirtërore” në vitin 2006, ku parashikohet edhe hedhja e hapave konkrete për katalogimin e trashëgimisë shpirtërore.

Do të përshëndesin workshopin Zj. Elida Petoshati nga Komisioni Kombëtar i Unesco-s pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, Akademik Myzafer Korkuti, nga Akademia e Shkencave Z. Izet Duraku, Drejtor i Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore; Prof. Dr. Miaser Dibra, Drejtore e Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe e Studimit të Arteve pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike.

Gjatë workshopit, Prof. Dr. Fatmir HYSI nga Akademia e Arteve, Fakulteti i Muzikës do të drejtojë seancën praktike të punës ku do të referojnë Akademik Vasil S. Tole kumtesën -“Konventa e Unesco-s për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore shpirtërore”; Magjistër Klodian Qafoku & Ma. Armand Zaceliqi do të referojnë “Dixhitalizimi i arkivit muzikor të Institutit të Antropologjisë Muzikore, sipas standardeve ndërkombëtare, arritje dhe risi” dhe Magjistër; dhe Ilir Parangoni do të prezantojë punën e bërë deri më tani për hatimin e “Database të iso-polifonisë popullore shqiptare”.

Për realizimin e këtij workshopi bashkëpunojnë disa institucione dhe shoqata kulturore si Akademia e Shkencave, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Arteve, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, Fondacioni “Albanian Heritage”, Seksioni Shqiptar i Cioff-it. Agjencia zbatuese e këtij aktiviteti është Këshilli i Muzikës Shqiptare, antar i IMC/ UNESCO ndërsa Agjencia Ekzekutive është Zyra e Venecias, UNESCO-BRESCE.